



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit,
Bashkinë Përmet, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të
Mbrojtura**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK “MBI ANKESËN E BANORËVE TË FSHATIT PISKOVË PËR VENDDEPOZITIMIN EKZISTUES TË MBETJEVE URBANE”

Tiranë, prill 2025

Nr.	Përmbajtja	
	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-3
I.	1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.	3-3
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	3-5
	3.Konkluzioni i përgjithshëm.	5-5
II.	HYRJE	6-8
	1.Objektivat dhe qëllimi.	6-6
	2. Identifikimi i çështjes.	6-6
	3.Përgjegjësitë e strukturave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Bashkisë Përmet, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.	6-6
	4.Përgjegjësitë e audituesve.	6-6
	5.Kriteret e vlerësimit.	6-7
	6.Standardet e Auditimit.	7-7
	7.Metodat e auditimit.	7-7
	8.Dokumentimi i auditimit.	7-8
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9-35
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	9-9
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit.	9-9
2.1	Zbatimi i dispozitave ligjore për studimin, projektimin, ndërtimin, operimin e venddepozitimit ekzistues të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.	9-16
2.2	Mbi auditimin e procedurave të dhënies së mendimeve si dhe miratimi i lejeve,licensave për ndërtimin dhe funksionimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.	16-24
2.3	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit publik.	24-32
2.4	Mbi auditimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve, monitorimeve për venddepozitimin ekzistues të mbetjeve në fshatin Piskovë.	32-35
IV.	REKOMANDIME	35-39

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a.Përshkrim i shkurtër i institucionit:

-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit.

-Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka për mision mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut.

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura, në varësi të ministrit dhe ka për detyrë administrimin e kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

-Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë (bashkia Përmet) është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të saj për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

b.Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Auditimi i këtyre institucioneve është fokusuar në çështje të posaçme që lidhen me zbatimin e dispozitave ligjore për studimin, ndërtimin, operimin e venddepozitimit ekzistues të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë si dhe kryerjen e inspektimeve për këtë venddepozitim mbetjesh urbane.

c.Qëllimi i auditimit:Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave nga subjektet e audituara.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

-Zbatimi i dispozitave ligjore për studimin, projektimin, ndërtimin, operimin e venddepozitimit ekzistues të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.

-Mbi auditimin e procedurave të dhënies së mendimeve si dhe miratimi i lejeve, licensave për ndërtimin dhe funksionimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.

-Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit publik.

-Mbi auditimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve, monitorimeve për venddepozitimin ekzistues të mbetjeve në fshatin Piskovë.

d.Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Realizimi i këtij auditimi u bazua në metodologjinë e auditimit të përcaktuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 7, datë 17.01.2024.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur vecmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme: verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e.Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucionet për periudhën nën auditim paraqesin të meta dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 7 gjetje dhe ka dhënë 7 rekomandime të karakterit organizativ.

f.Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Nga auditimi në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Bashkinë e Përmetit u konstatuan disa mangësi, ku disa më kryesoret janë:

-Nga auditimi u konstatua se Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve vendosi rehabilitimin e venddepozitimit të Brackovës¹, me qëllim për të rritur kohën e funksionimit të tij. Ndërkohë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në rolin e zhvilluesit, nisi procedurën e aplikimit për tu pajisur

¹ E konfirmuar edhe nga observacionet me nr.968/10 prot., datë 18.10.2024 të sjella nga nëpunësi civil që ka mbajtur protokollin/procesverbalin e takimit të Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve.

me VNM paraprake dhe me leje infrastrukturore, për ndërtimin e një venddepozitimi të ri në fshatin Piskovë, veprime në kundërshtim me Vendimin e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, nr.10, datë 18.11.2020.

-Nga auditimi është konstatuar se dosja e aplikimit për VNM paraprake dhe për leje infrastrukturore, përsa i përket venddepozitimit të mbetjeve urbane në Piskovë, ka rezultuar me mangësi në dokumentacion, kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

-Nga verifikimi i kryer në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë rezultoi se:

U konstatua se nuk bëhet ndarja e mbetjeve në venddepozitim;

Mbeturinat janë hedhur në mënyrë jo të rregullt dhe nuk kryhet në mënyrë permanente procesi i presimit, shtresëzimit dhe mbulimit me dhë;

Gjatë verifikimit në vend, masat mbrojtëse në krahun nga ana e lumit, nuk janë të plota dhe të mbuluara nga dherat;

Një pjesë e mbetjeve ndodhen jashtë gropës së venddepozitimit dhe për rrjedhojë ujërat sipërfaqësor të ndotur nga mbetjet, mund të devijojnë jashtë kanaleve kulluese;

Venddepozitimi nuk monitorohet me personel gjatë gjithë kohës, gjë e cila mund të bëhet shkak i dëmtimit të rrethimit dhe ndërhyrjeve të paligjshme, siç është zjarrvënia, hyrja e kafshëve, në kundërshtim me ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 43, pikat 6 e 7, neni 44, pika 3, neni 45 e 64 si dhe Vendimit nr. 452, datë 11.7.2012 “Për Lendfillet e Mbetjeve”, Aneksi I.

-Nga auditimi u konstatua se në dosjen e prokurimit "Shërbim konsulence", mungon "marrëveshja e noterizuar" ndërmjet operatorëve ekonomik, në kundërshtim me nenin 44, pika 2 të Ligjit nr. 9643 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 74, pika 2 dhe 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”.

-Nga auditimi i kryer rezultoi se institucionet me funksion inspektimi si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk kanë kryer inspektime në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë dhe në zonën e mbrojtur Parku Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 38, pika 1 dhe me Ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, neni 25/1, pika 3.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë në shqyrtim rastin e mësipërm duke nxjerrë të gjitha përgjegjësitë, si dhe të marrë masa që në të ardhmen këto praktika t’i kryejë konform dispozitave ligjore.

-Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Bashkia e Përmetit të marrin masa që përpara miratimit të VNM –ve paraprake dhe lejeve infrastrukturore të verifikojnë se aplikimi i kryer është në përputhje me të gjitha kriteret sipas legjislacionit në fuqi.

-Bashkia Përmet të marrë masa për vendosjen në kushte teknike të përpikta për operimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë si: mbulimin e mbetjeve me dhë, mbledhjen e ujërave sipërfaqësor, vendosjen e sistemit të evakuimit të gazit.

-Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për verifikimin e saktë të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomik.

-Drejtoria e Kontroll-Inspektimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrë masa për të inspektuar Bashkinë e Përmetit, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve si dhe venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, raport i cili të dërgohet edhe në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

I. Konkluzioni i përgjithshëm

Nga auditimi i kryer pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Bashkisë Përmet në lidhje me “Ankesën e banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me venddepozitimin e mbetjeve urbane” rezultuan mangësi kryesisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Nga auditimi u konstatua se venddepozitimi i Piskovës nuk ka qenë i raportuar si venddepozitim ilegal, në Raportin Final të përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe si pasojë nuk mund të ndiqej procedura “e rehabilitimit”.

Për venddepozitimin ekzistues të Piskovës mungon dokumentacioni: studimi sizmik, klimatiko-meteorologjik, vërtetim nga kadastra e bashkisë /qarkut mbi kategorizimin e truallit që kërkohet për shfrytëzim, vëzhgime, prova dhe teste të terrenit, opinioni publik (dëgjesa me publikun), dokumentat e pronësisë, procedurat e përzgjedhjes së vendit për ndërtimin e landfillit (është marrë në konsideratë vetëm një alternativë), vlerësimi ekonomik, oponenta teknike nga Instituti i Ndërtimit, miratimi i studimit në organet e tjera përkatëse.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.968/6 prot., datë 12.09.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 16.09.2024 deri në datën 11.10.2024 u krye Auditimi Tematik “Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me venddepozitimin e mbetjeve urbane”.

Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.Sh. H., Përgjegjës grupi;
- 2.P. I., anëtar;
- 3.K. P., anëtar;
- 4.B. K., anëtar.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.

Identifikimi i çështjes:

Nëpërmjet këtij auditimi kërkohet të identifikohet zbatimin e dispozitave ligjore për studimin, projektimin, ndërtimin, operimin e venddepozitimit në fshatin Piskovë; zbatimin e procedurave të dhënies së mendimeve si dhe miratimi i lejeve, licensave; planifikimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit publik; zbatimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve, monitorimeve në lidhje me venddepozitimin e sipërpërmendur.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat drejtuese të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Bashkisë Përmet, janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit).

Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit e KLSH-së janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikën, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj; duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe Kodin e Etikës.

Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit e KLSH-së, miratuar me Vendimin të Kryetarit të KLSH nr.58, datë 08.04.2022; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), “Udhëzuesit e INTOSAI-t”; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikën më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik.

Gjithashtu, janë marrë parasysh edhe përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Bashkisë Përmet, e konkretisht disa prej tyre si; Ligji nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar; Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; Ligji Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Vendimi Nr.452, datë 11.7.2012 “Për Lendfillet e mbetjeve” i ndryshuar; Udhëzimi Nr.1738, datë 12.3.2015 “Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e lendfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”; Ligji Nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”; Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, etj.

Standardet e auditimit:

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.07, datë 17.01.2024, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre, etj.

Metodat e auditimit:

a. Metoda "Testim hap pas hapi": Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.

b. Metoda e ekzaminimit: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve.

c. Metoda e ekzaminimit kryq: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.

d. Metoda e inspektimit fizik: Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.

e. Metoda e intervistimit: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacioni gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësive të audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve, duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjëra). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

f. Metoda e testimit të detajuar: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

Dokumentimi i auditimit:

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë.

Dokumentimi i Auditimit është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 07, datë 17.01.2024 si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI).

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektet nën auditim

-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave për turizmin.

-Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka për mision mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura, në varësi të ministrit dhe ka për detyrë administrimin e kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKZM-ja ka statusin e Drejtorisë së Përgjithshme, në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas administratave rajonale të zonave të mbrojtura.

-Bashkia Përmet është e organizuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregulloren e funksionimit dhe organizimit të Bashkisë Përmet si dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Përmet. Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

Në zbatim të tematikës së Programit të Auditimit nr.968/1 prot., datë 12.09.2024, protokolluar në Bashkinë Përmet me nr.2347 prot., datë 13.09.2024; Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me nr.5613/1 prot., datë 13.09.2024; Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me nr. 9527 prot., datë 13.09.2024 dhe në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura me nr.3020/1 prot., datë 13.09.2024, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1.Raporti final “Për zbutjen e riskut mjedisor”;

2.Dokumentacioni i korrespondencës ndërmjet institucioneve: Bashkia Përmet-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit-Agjencia Kombëtare e Mjedisit-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;

3.Procedura e projektimit “Studim, mbyllje, rehabilitim i mbetjeve urbane në bashkinë Përmet”;

4.Lejet/licencat e venddepozitimit të mbetjeve urbane në Piskovë.

2.1.Zbatimi i dispozitave ligjore për studimin, projektimin, ndërtimin, operimin e venddepozitimit ekzistues të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.

- Në bazë të urdhrin nr.35, datë 02.02.2018 të Ministrit të Mjedisit, z. B. K është ngritur grupi i punës “Task Forcë për identifikimin e venddepozitimeve informale që do të rehabilitohen”. Në raportin final “Zbutja e riskut në venddepozitime ilegale“ të përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit u identifikuan 198 venddepozitime në të gjithë territorin e vendit. Grupi i punës ka raportuar se në Bashkinë Përmet janë dy venddepozitime ilegale: venddepozitimi i Brackovës dhe venddepozitimi tek varrezat publike të qytetit. Për të dyja venddepozitimet ilegale në Bashkinë e Përmetit është propozuar rehabilitimi si dhe janë parashikuar koston e përlllogaritura (për të rritur

kohën e funksionimit të venddepozitimeve). Për sa i përket venddepozitimit të mbetjeve urbane në Brackovë, kostoja e rehabilitimit ishte 5.998.963 lekë, ndërsa për venddepozitimin ilegal pranë “varrezave të qytetit”, kostoja e ndërhyrjes ishte 4.193.823 lekë.

-Me shkresën nr.9322 prot., datë 19.11.2018, zv.Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit znj. O. Çiu drejtua Kryetarit të Bashkisë Përmet, z. N. Sh *“ka përfunduar identifikimi i venddepozitimeve në rang vendi. Në bashkinë që ju drejtoni janë evidentuar dy venddepozitimet e mëposhtme: venddepozitimi në zonën e Brackovës dhe venddepozitimi në zonën tek varrezat publike të qytetit. Afati përfundimtar për përgatitjen e Planit të Përmirësimit të venddepozitimeve dhe miratimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit është deri në 31 Dhjetor 2018. Ndërkohë nga ana Juaj, ky plan nuk është dorëzuar ende pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit...”*

-Me shkresën nr.2985 prot., datë 23.11.2018, Kryetari i Bashkisë Përmet z. N. Sh. i drejtohet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke i dërguar projektin dhe marrjen e masave për rehabilitimin e venddepozitimit në Brackovë.

-Me shkresën nr.673 prot., datë 21.03.2019, Kryetari i Bashkisë Përmet, z. N. Sh. i ka kërkuar Ministrin të Turizmit dhe Mjedisit, z. B. K, mbështetje financiare, për të përmirësuar standartet e venddepozitimit në vendin e quajtur Brackovë.

-Me urdhrin nr.152, datë 15.05.2019, Titullari i Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, z. P. A. ka urdhëruar të kryhet procedura e prokurimit “shërbimi konsulence” me objekt “Studim, mbyllje, rehabilitim i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale”.

-Me shkresën nr.679/1 prot., datë 18.06.2019, Bashkia Përmet i drejtohet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke i dërguar planin e përmirësimit dhe marrjen e masave për rehabilitimin e venddepozitimit në Brackovë.

-Në datën 07.08.2019, një nga subjektet fitues të procedurës së prokurimit publik (DC*) ka kryer inspektim në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Brackovë. Në akt-inspektimin e mbajtur nga subjekti fitues, përmendet se *“kërkesa e bashkisë Përmet ishte të ndërtohej një lëndfill i ri në fshatin Piskovë. Sipërfaqja e propozuar e lëndfillit është 7000 m²”*.

-Me shkresën nr.7340 prot., datë 15.08.2019, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, z. A. K. ka dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit planin e përmirësimit të venddepozitimeve të mbetjeve për 9 bashki (bashkia Përmet, Vlorë, Roskovec etj), sipas planeve që kishin dërguar bashkitë respektive. Bashkia Përmet kishte dërguar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, planin e përmirësimit për venddepozitimin e Brackovës (me nr. 679/1 prot., datë 18.06.2019).

-Me shkresën nr.4151 prot., datë 14.10.2019, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, z. E. K. i kthen përgjigje Bashkisë Përmet se *“programi i përmirësimit për venddepozitimin ekzistues nuk miratohet për arsye se, nuk i përmbahet tabelës 'përshkrimi i masave dhe zbatimit të tyre, si dhe nuk janë specifikuar kostot e të gjithë zërave të punimeve”*.

-Me shkresën nr.3425 prot., datë 19.05.2020, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit z. A. K, dërgon planin e përmirësimit të venddepozitimit të Piskovës në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.


Nga auditimi është konstatuar se ky venddepozitim nuk është identifikuar në raportin final të përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe si pasojë nuk mund të rehabilitohej.

-Me shkresën nr.1694/4 prot., datë 25.05.2020, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dërgon në Komitetin Ndërmnistror për Mbetjet kthim-përgjigjen *“duke iu referuar materialeve të dërguara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr.3425 prot., datë 19.05.2020, miratojmë planin e masave për përmirësimin e venddepozitimit ekzistues të Bashkisë Përmet”*.

-Me relacionin nr.5672 prot., datë 12.11.2020, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dërgon në Komitetin Ndërmnistror për Mbetjet relacionin mbi klasifikimin e venddepozitimeve të Bashkisë Divjakë, Kavajë, Krujë, Kukës, Libohovë, Mat, Përmet, Roskovec, Korçë dhe Peqin. Në relacion citohet se “venddepozitimi i Brackovës nuk është i vendosur në zona të dukshme dhe si rrjedhim nuk rrezikon degradimin e peisazhit përreth. Venddepozitimi është klasifikuar i kategorisë A (më shumë se 18 pikë)”. Në relacionin e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përshkruhet venddepozitimi i Brackovës, por vendosen koordinatat gjeografike të venddepozitimit në fshatin Piskovë.²

-Me vendimin nr.10, datë 18.11.2020, Komiteti i Menaxhimit të Mbetjeve ka vendosur “miratimin e planit të përmirësimit të venddepozitimit ekzistues të bashkisë Përmet. Afati i përdorimit të venddepozitimit të rehabilituar për depozitimin e mbetjeve urbane në territorin e bashkisë do të jetë deri në zgjidhjen përfundimtare të pikës fundore rajonale. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit të anëtarëve nga Komiteti”.

-Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (në rolin e zhvilluesit) ka vijuar procedura: e aplikimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM paraprake) dhe për leje infrastrukturore për ndërtimin e një objekti (venddepozitimi) në fshatin Piskovë në njësinë administrative Qendër Piskovë. Më poshtë, paraqitet skema grafike, e procedurave që janë ndjekur nga institucionet për ndërtimin e venddepozitimit të Piskovës.



Burimi: MTM-AKM-Bashkia Përmet. Punoi: Grupi i auditimit

² Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion shkresa, e cila është firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

- Për sa më lart, grupi i auditimit ka konstatuar mangësi në institucionet: Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Bashkinë Përmet, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, sa i përket studimit, ndërtimit, operimit të venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë. Në mënyrë të detajuar mangësitë janë pasqyruar si më poshtë:

1.Subjekti i audituar: **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.**

Çështjet e audituara: Audituesit e KLSH-së, kanë kërkuar informacion nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për vënie në dispozicion të dokumentacionit, konkretisht;

- 1.Raportin final “Për zbutjen e riskut mjedisor”;
- 2.Procedurën e projektimit “Studim, mbyllje, rehabilitim i mbetjeve urbane në bashkinë Përmet”;
- 3.Procedurën e aplikimit për certifikatë përdorimi për venddepozitim të mbetjeve urbane në Piskovë etj.

Për sa më lart, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit konstatohet se;

1.Përsa i përket venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë rezulton se procedura e përzgjedhjes së vendndodhjes ka mangësi të tilla si:

-Përzgjedhja e vendndodhjes së venddepozitimit në fshatin Piskovë është bërë në kundërshtim me “Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e mbetjeve të ngurta”, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, datë 13.01.2020 dhe me Vendimin Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve” i ndryshuar, aneksi 1 si dhe me Udhëzimin nr. 1738, datë 12.3.2015 “Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”, ku përcaktohet se “Për përcaktimin e një venddepozitimi kërkohet të merren në konsideratë të dhëna të përgjithshme, për të paktën 10 variante të mundshme mbi vendndodhjen, nga ku të evidentohen avantazhet dhe disavantazhet për secilin variant dhe në bazë të një vlerësimi/pikëzimi të përcaktohen 3 variantet më të përshtatshmet, të cilat do të përfshihen në studimin për ndërtim”. Në studimin e paraqitur nga subjekti fitues (i procedurës së prokurimit publik) është dhënë vetëm një alternativë për ndërtimin e venddepozitimit, me vendndodhje në fshatin Piskovë, Përmet.

-Studimi i projektit “Studim, mbyllje, rehabilitim i mbetjeve urbane në Përmet“ nuk është nënshkruar nga subjekt që është i pajisur me licencë për kategorinë “Studime e projekte të ndërtimit dhe mbylljes së venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta (urbane)”, kjo në kundërshtim me Vendim nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, lidhja 2, “Kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim”, pika 13.

-Për ndërtimin e venddepozitimit të ri në fshatin Piskovë mungon dokumentacioni si më poshtë: studimi sizmik, klimatiko-meteorologjik, vërtetim nga kadastra e bashkisë/qarkut mbi kategorizimin e truallit që kërkohet për shfrytëzim, vëzhgime, prova dhe teste të terrenit, opinionin publik (dëgjesa me publikun), dokumentat e pronësisë, procedurat e përzgjedhjes së vendit për ndërtimin e venddepozitimit, vlerësimi ekonomik, oponenca teknike nga Instituti i Ndërtimit, miratimi i studimit në organet e tjera përkatëse, kjo në kundërshtim me shtojca 2 “Për hartimin, dokumentacionin i nevojshëm për studim-projektimin e një landfilli apo impianti trajtimi për mbetjet e ngurta urbane”.

2. Me shkresën nr.3425 prot., datë 19.05.2020, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, z. A. K. ka dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit planin e përmirësimit, duke ndryshuar vendndodhjen e venddepozitimit nga fshati Brackovë në fshatin Piskovë (në raportin final venddepozitimi i mbetjeve urbane në fshatin Piskovë nuk ka qenë i raportuar (ekzistues) dhe si pasojë nuk duhet të kishte plan përmirësimi për rehabilitimin e tij). Për sa më lart, Anëtarët e Sekretariatit Teknik, z. R. B, znj. L. K, znj. D. Xh nuk kanë shqyrtuar relacionin e sjellë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në të cilën ka patur pasaktësi si: *“përshkruhet venddepozitimi i Brackovës, por vendosen koordinatat e venddepozitimit në fshatin Piskovë”*, kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 452, datë 11.7.2012 *“Për lëndfillët e mbetjeve”* i ndryshuar, kreu XI, pika 28 përcakton se *“Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastet kur miraton planin e përmirësimit, përgatit një relacion shpjegues teknik për Sekretariatit Teknik të Komitetit, i cili dërgohet së bashku me planin e përmirësimit. Relacioni shpjegues përmban të dhëna mbi pikëzimin e venddepozitimit, si dhe impaktin mjedisor, ekonomik e social të zonës ku ndodhet lëndfilli. Sekretariati shqyrton të gjithë dokumentacionin e përcjellë nga AKM-ja dhe i përgatit një relacion përmbledhës Komitetit”*.

3. Shkresa e dërgimit të planit të përmirësimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit është konceptuar nga znj. V. G, përgjegjëse e Sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve IPA dhe Donatorëve të Tjerë në Ministri të Turizmit dhe Mjedisit, kjo në kundërshtim me Rregulloren e brendshme *“Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”* (me nr. 9034/1 prot., datë 07.11.2018), nenin 16, pika b, e cila përcakton se *“detyrat e përgjegjës të sektorit: përgjigjet për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve brenda sektorit që drejton duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë drejtorisë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme”*. Theksojmë, se financimi i venddepozitimit është bërë nga Buxheti i Shtetit.

4. Është lëshuar autorizim nga z.A. K, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 337/7 prot., datë 28.06.2021, për z.E. D, me qëllim që të kryejë aplikimin e lejeve të ndërtimit për 5 venddepozitimet në bashki të ndryshme (edhe për bashkinë Përmet). Objekti i aplikimit është *“mbyllja, rehabilitim i mbetjeve urbane nga venddepozitimet urbane ilegale”*. Për sa i përket Bashkisë Përmet, në autorizimin e sipërpërmendur, janë vendosur koordinatat e venddepozitimit që do të ndërtohej në fshatin Piskovë: X=439150.699; Y=4458956.721. Sa më sipër, nuk është respektuar Vendimi i Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve që përcakton *“miratimin e planit të përmirësimit të venddepozitimit ekzistues të bashkisë Përmet”*.

5. Nga ana e Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nuk është aplikuar në sistemin e-leje për certifikatë përdorimi për objektin e venddepozitimit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, neni 62, pika 1, i cili përcakton se *“Në fund të procesit të zhvillimit, autoriteti përgjegjës i planifikimit lëshon certifikatën e përdorimit të objektit, që vërteton përfundimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, si dhe zbatimin e kritereve të dokumenteve të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit”* dhe në kundërshtim me pikën 7 të Lejes infrastrukurore, nr. 4, datë 17.11.2021 (leja infrastrukurore për ndërtimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë), që përcakton se *“Zhvilluesi është i detyruar që, pas përfundimit të ndërtimit dhe përpara përdorimit të tij, të kërkojë nëpërmjet aplikimit elektronik e-leje nga bashkia që të pajiset me certifikatën e përdorimit të tij”*.

-Lidhur me projekt raportin, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është paraqitur observacioni me shkresë me nr.5613/4 prot., datë 18.10.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Z. R. B, znj. L. K, znj. D. Xh kanë paraqitur observacionet si më poshtë:

-Pika 1 "venddepozitimi ekzistues në njësinë Administrative Piskovë është në përputhje me raportin e përgatitur në vitin 2018 "Zbutja e riskut në venddepozitime". Ky raport ka si objektiv evidentimin e venddepozitimeve në të gjithë territorin e vendit dhe bazuar në vlerësimet ligjore dhe teknike orienton organet vendimmarrëse në nivel qendror dhe lokal në përzgjedhjen e atyre që kanë risk më të ulët për popullatën dhe mjedisin. Bashkia Përmet përzgjedhi venddepozitimin me risk më të ulët për të rehabilituar për një periudhë të caktuar deri në zgjidhjen rajonale që parashikohet të kryhet sipas studimit të fizibilitetit për rajonin "Vlorë Jug-Gjirokastrë".

Pika 2. Përzgjedhja e venddepozitimit ekzistues është bërë nga bashkia Përmet, nëpërmjet shkresës që ka bërë Ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Si u theksua, përzgjedhja e venddepozitimit është në përputhje me raportin " Zbutja e riskut në venddepozitime" .

Pika 4. Vendimi i Komitetit është i vlefshëm kur arrihet kuorimi, pra kur nënshkruhet nga shumica e anëtarëve.

Pika 9. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka dërguar në AKM, planin e përmirësimit sipas kërkesës së sjellë nga Bashkia Përmet për venddepozitimin në njësinë administrative në Piskovë, mbi bazën e të cilës është bërë vlerësimi dhe pikëzimi në AKM. Pra, Sekretariati Teknik lehtëson punën e Komitetit duke përgatitur relacionin përmbledhës, por pa inspektuar në terren kushtet e venddepozitimit, vendndodhjen dhe koordinatat e tij.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Pasi shqyrtoi pretendimet e paraqitura nga z. R. B, znj. L. K, znj. D. Xh, nga grupi i auditimit merren pjesërisht në konsideratë, si më poshtë. Në lidhje me pretendimin 1 dhe 2 "se venddepozitimi i Piskovës ka qenë venddepozitim i raportuar në raportin final të përgatitur nga MTM, në vitin 2018", sqarojmë se: Në bashkinë e Përmetit janë raportuar 2 venddepozitime ilegale: i Brackovës dhe afër varrezave publike të qytetit. Referuar kthimit të përgjigjes nga Bashkia Përmet, gjatë fazës audituese në terren, të dy venddepozitimet e sipërpërmendura ndodhen në një largësi të konsiderueshme me venddepozitimin aktual që ndodhet në Piskovë (objekt i auditimit tematik). Theksojmë se, venddepozitimi i Piskovës është një instalim i ri dhe nuk ka qenë venddepozitim ekzistues në vitin 2018 dhe si pasojë nuk mund të ndiqej procedura për "rehabilitimin" e tij.

Në lidhje me pikën 4 merret në konsideratë dhe pasqyrohet edhe në pjesën e projekt raportit.

Në lidhje me pikën 9 se "Sekretariati Teknik lehtëson punën e Komitetit", pretendimi nuk qëndron. Sekretariati shqyrton dokumentacionin e sjellë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Pretendimi i subjektit: Znj. V. G ka paraqitur pretendimin si vijon: "Konceptimi i shkresës ka qenë një rast sporadik sikundër ka ndodhur rëndom me kërkesë verbale të eprorit R. B. Z R. B pas kërkesës për hartimin e shkresës ka dhënë edhe miratimin e tij me firmosjen e shkresës në fjalë. Kjo kërkesë për të konceptuar shkresën është bërë për arsye mungese të përgjegjëses së sektorit të mbetjeve znj. L. K, e cila mund të ketë munguar".

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Nuk është paraqitur dokumentacion provues dhe vërtetues.

-Lidhur me projekt raportin e grupit të auditimit, nga z. P. H. është paraqitur observacioni me shkresë me nr.968/10 prot., datë 18.10.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: "Roli im në Sekretariat ka qenë në zbardhjen e të gjithë procesverbaleve si dhe menaxhimin e takimeve në rezervimin e sallës. Referuar pikës të akt konstatimit, si dhe takimit të mbajtur online me anëtarët e Komitetit në nivel zv.ministri, për bashkinë Përmet, marrja e

vendimit nga ana e anëtarëve të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve ka qenë për venddepozitimin e Brackovës dhe jo të Piskovës”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit, merret në konsideratë dhe reflektohet në pjesën e projektit raportit.

-Lidhur me projekt raportin e grupit të auditimit, nga z. A. K. është paraqitur observacioni me shkresë me nr.968/13 prot., datë 21.10.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:“Duke qenë se unë personalisht, nuk kam qenë i përfshirë në asnjë nga grupet (Task Forcë-Komiteti i Menaxhimit të Mbetjeve-komisionet përkatëse) konsideroj se nuk duhet të përfshihem në këto akt-konstatime si person me përgjegjësi, duke qenë se të gjitha veprimtaritë janë kryer nga persona të autorizuar, për të realizuar detyra të ngarkuara specifíkisht. Roli i Sekretarit të Përgjithshëm në këtë rast është vetëm përfaqësimi i institucionit me palët e treta, ndërkohë që të gjitha specifíkimet dhe detajet janë konfirmuar nga persona të autorizuar specifíkisht”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë. Referuar Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme me nr.9034/1 prot., datë 07.11.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit", neni 13 përcakton se "Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në ministri. Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi: të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e zbatimin të politikave të MTM; të sigurojë drejtimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e MTM; të sigurojë administrimin efektiv dhe efícent të burimeve financiare, materiale dhe njerëzore të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

-Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

1. Z. A. K, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
2. Z. P. A, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit;
3. Z. R. B, në cilësinë e Drejtorit të Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit;
4. Znj. L. K, në cilësinë e anëtares së Sekretariatit Teknik të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;
5. Znj. D. Xh, në cilësinë e anëtares së Sekretariatit Teknik të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

2.1.1 Auditim mbi relacionet: gjeologjik, hidrologjik, topografik, teknik, raportit të VNM-së, të venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.

-Nga auditimi në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, u konstatua se në dokumentat e mbajtura pas kryerjes së studimeve si: studimi topografik, studimi gjeologjik, studimi hidrologjik, raport i VNM-së dhe dokumenta që kanë të bëjnë me studimin funksional të venddepozitimit nuk janë të nënshkruara dhe të konfirmuara nga personat përgjegjës të cilët kanë kryer studimin.

Pretendimi i subjektit: Në observacionin nr. 5313/4 prot., datë 18.10.2024 ardhur nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit përshkruhet se “Studimet janë kryer nga subjektet “DC” shpk, disponon licensën 4497/7, “A C” shpk, disponon licensën 5628/6, “U 0” shpk, disponon licensën 5737/8” dhe personat mbajnë përgjegjësi që kanë hartuar dokumentat.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas verifikimit të dokumentacionit, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë. Nuk jepet asnjë arsye pse nuk janë firmosur nga personat përgjegjës, dokumentat studimore.

-Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

1. Znj. Sh. H, në cilësinë e anëtares së grupit të punës (për marrjen në dorëzim të shërbimit referuar procedurës së prokurimit shërbim konsulence);
2. Znj.V. G, në cilësinë e kryetares së grupit të punës (për marrjen në dorëzim të shërbimit referuar procedurës së prokurimit shërbim konsulence);
3. Z.Sh. K, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës (për marrjen në dorëzim të shërbimit referuar procedurës së prokurimit shërbim konsulence).

2.2.Mbi auditimin e procedurave të dhënies së mendimeve si dhe miratimi i lejeve, licensave për ndërtimin dhe funksionimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.

➤ **Subjekti i audituar:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Çështjet e audituara: Audituesit e KLSH-së kanë kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për vënie në dispozicion të dosjes së aplikimit (VNM paraprake) për ndërtimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.

Lidhur me auditimin në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (në rolin e zhvilluesit), në datë 13.10.2021, (AN131020210003) ka aplikuar në e-albania, për t'u pajisur me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM paraprake), për të zhvilluar projektin “Studim, mbyllje, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale-Përmet”.

-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nga marrja e aplikimit të VNM-së ka përcjell aplikimin pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), të shoqëruar dhe me mendimin sugjerues të drejtorive teknike.

-Mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis (Drejtori në Ministri të Turizmit dhe Mjedisit) për këtë projekt nënvizon se *“Raporti duhej të kishte marrë parasysh alternativa të tjera në lidhje me projektin, si për vendin e zhvillimit ashtu edhe për modifikimet e mundshme në faza të ndryshme të tij. Një vlerësim i duhur i alternativave përfshin përshkrimin e tyre, paraqitjen e pasojave të tyre mjedisore dhe një shpjegim të arsyeve për pranimin ose refuzimin e tyre. Gjithashtu, burimet e të dhënave për mjedisin ekzistues nuk janë referuar si duhet. Nuk janë përshkruar ndikimet kumulative të projektit në mjedis, së bashku me zhvillimet e tjera ekzistuese ose të planifikuara të zonës”*.

-Pas marrjes së aplikimit, AKM-ja e ka dërguar për mendim një kopje të aplikimit në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë; Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura; Bashkinë Përmet.

-Në datë 22.10.2021, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka miratuar Vendim për VNM paraprake për projektin “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale-Përmet”.

Për sa më lart konstatohet se:

1.Komisioni i Shqyrtimit të Aplikimeve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit nuk ka marrë në konsideratë mendimin e dhënë nga Drejtoria Teknike pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që përmend se *“subjekti duhet të merrte në konsideratë alternativa të tjera në lidhje me projektin, si për vendin e zhvillimit...”*, kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 686, datë 29.7.2015 *“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklarates mjedisore”*, kreu I, pika 9, përcakton se *“Në rast se institucionet e konsultuara më lart kërkojnë informacion shtesë,*

AKM-ja, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga marrja e mendimeve, i kërkon zhvilluesit, me shkrim, plotësimin e informacionit që mungon, duke dhënë edhe arsyetimin përkatës dhe duke vënë në dijeni edhe Ministrinë. Afati për plotësimin e informacionit nga zhvilluesi nuk mund të jetë më i gjatë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.”

2.Raporti paraprak i VNM-së ka mangësi të tilla si; mungojnë të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës, që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo të funksionimit të veprimtarisë së projektit; mungon programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit, mungon informacioni për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret etj., kjo në kundërshtim me Vendimin Nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, Lista e kontrollit pika 4.1.1.

3.Relacioni mbi klasifikimin e venddepozitimit të Bashkisë Përmet i dërguar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit ka pasaktësi të tilla: përshkruan venddepozitimin e Brackovës, por pozicioni gjeografik i venddepozitimit është në fshatin Piskovë.³

4.Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, znj. A. D nuk ka marrë masa për të ngritur një grup pune për të verifikuar pretendimet e banorëve të Piskovës, (shkresa me nr. 6711 prot., datë 29.12.2021).

-Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit është paraqitur observacioni⁴ me shkresë me nr.968/11 prot., datë 21.10.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (z. E.K, znj. E. M): Në lidhje me pretendimin e pikës 1 të akt konstatimit sqarojmë se “*Aplikimi është kryer nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Në rast se MTM konstaton se në dosjen elektronike të aplikimit ka mungesë informacioni, brenda 10 ditësh kërkon me shkrim plotësimin e dokumentacionit që mungon. Pra, MTM nuk ka kërkuar informacion shtesë por ka dhënë mendime sygjeruese në funksion të procesit të VNM-së. Ju sjellim në vëmendje se aplikimi është bërë për një aplikim illegal ekzistues. Vendimi i dhënë për një procedurë aplikimi nuk është personal, por kolegjal. Komisioni i Shqyrtimit të Aplikimeve për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nr. 48 , përbëhet nga 1+8 anëtarë të AKM. Komisioni i Shqyrtimit të Aplikimeve (bazuar në urdhërin e nr. 154, datë 29.20.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM) përbëhet nga anëtarët: znj.E. M-përgjegjës i sektorit të VNM-së, znj. J. M -përgjegjës i sektorit juridik dhe marrëdhëniet ligjore, znj. J. T-specialiste e VNM-së, znj. E. Sh-specialiste e sektorit të VNM-së, znj. E. Z-specialiste e sektorit të VNM-së, z. O. Dh-specialist i sektorit të lejeve mjedisore, znj. L. Gj-përgjegjës i sektorit të monitorimit, znj. O. N, specialiste e sektorit të VNM-së”.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur, kjo pikë e observacionit merret në konsideratë, konkretisht: shqyrtimi i aplikimit “Studim, rehabilitim i mbetjeve urbane nga venddepozitime ilegale”, është kryer nga një komision i posaçëm.

Grupi i auditimit është vendosur në dijeni të këtij fakti, gjatë përgatitjes së projekt raportit (observacioneve të sjella nga znj. E. M) ku nënvizon se “Vendimi i VNM-së paraprake për

³ Në shkresën e vendosur në dispozicion grupit të auditimit, shkresa është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, z. E. K.

⁴ Z.E. K (shkresa nr.968/8 prot., datë 16.10.2024) dhe znj. E. M(shkresa nr.968/9 prot., datë 17.10.2024) kanë dorëzuar observacione në KLSH. Me shkresën nr.968/11, datë 21.10.2024 , Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka bashkëngjitur edhe observacionet e dorëzuara pranë AKM-së, të z. K dhe znj. M, të cilat janë trajtuar më sipër.

ndërtimin e lëndfillit në fshatin Piskovë është marrë nga anëtarët e komisionit...”. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, merret në konsideratë dhe reflektohet në pjesën e projektit raportit.

Përsa i përket pjesës tjetër të pretendimeve, nuk merren në konsideratë. Theksojmë se në raportin e VNM-së përshkruhet se “Zona në të cilën është zhvilluar studimi ndodhet në Piskovë, njësinë administrative Përmet, e cila është pjesë e Qarkut të Gjirokastrës (faqja 10 e raportit të VNM-së)”. Gjithashtu, edhe Vendimi i zbardhur i VNM-së (faqja 8), aneksi 1, “harta me koordinatat”, vendndodhja e venddepozitimit është në fshatin Piskovë, kjo në kundërshtim me Vendimin e Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve (i cili vendosi për rehabilitimin e Brackovës).

Pretendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (z. E.K, znj. E. M):Në lidhje me pikën 2 të akt konstatimit sqarojmë se “Të gjitha pikat janë cituar në raportin teknik dhe VNM paraprake.”

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur, ky pretendim nuk qëndron. Në raportin e VNM-së nuk janë përshkruar të gjitha pikat e nevojshme për një VNM paraprake, e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Pretendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (znj. A. D): Në kohën kur është dhënë Vendimi për VNM paraprake, nuk kam qenë pjesë e vendimmarrjes.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit, grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është vendosur në dijëni nga banorët e Piskovës (shkresa me nr. 6711 prot., datë 29.12.2021), se “Ministria e Mjedisit nëpërmjet ndërtimit të lëndfillit në fshatin e Piskovës po ndot ujën e pijshëm” dhe Titullari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit znj. A. D nuk ka marrë masa për të ngritur një grup pune për verifikimin e pretendimeve të banorëve.

-Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë paraqitur observacionet me shkresë nr.12800/3 prot., datë 18.12.2024 dhe me shkresë nr.12800/5 prot., datë 17.12.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit” nga znj. A. D, z. E. K⁵, znj. E. M, znj. E. Z ku janë shprehur objeksionet.

-Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit të bërë, sqarojmë se observacionet e sjella nga subjekti janë të njëjta si në fazën e hartimit të projektit raportit dhe Raportit Përfundimtar. Nga grupi i auditimit nuk janë marrë në konsideratë, pasi pretendimet e mësipërme nuk janë të mbështetura me dokumenta justifikues.

Pretendimi i Agjencisë Kombëtare e Mjedisit (znj. O. N, znj. J. T, znj. E. Sh, z. O. Dh)⁶: “Grupi i auditimit ka marrë në konsideratë se shqyrtimi është bërë nga komisioni i posaçëm i VNM-ve. Nuk është marrë në konsideratë Urdhëri nr.154, datë 29.10.2020 “Mbi krijimin e Komisionit Teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”. Në zbatim të urdhërit të mësipërm, komisioni përbëhej nga: Drejtor i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, përgjegjës i sektorit juridik, përgjegjës i sektorit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, përgjegjës i sektorit të lejeve mjedisore, specialist i sektorit të VNM (prezantim), specialist i sektorit të VNM (protokoll). Komisioni është në rang përgjegjësish, i cili nuk është reflektuar në procesverbalin e mbledhjes së komisionit nr.48. Prezenca në komision ka qenë në bazë të urdhërit verbal nga eprori i drejtëpërdrejtë dhe titullari i institucionit”.⁷

-Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit të bërë, sqarojmë se procesverbali i komisionit nr.48 (ku është marrë vendimi për VNM paraprake për projektin “studim, mbyllje, rehabilitim i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale –Përmet”) është

⁵ Observacion me shkresë me nr. 968/20 prot., datë 18.12.2024.

⁶ Znj.O. N dhe znj. J. T-observacion me shkresë me nr. 12800/3 prot., datë 18.12.2024;

Znj. E. Sh-observacion me shkresë 968/19, datë 12.12.2024;

Z.O. Dh-observacion me shkresë me nr.12800/5 prot., datë 17.12.2024.

⁷ Meqënëse përmbajtja e observacioneve është e njëjtë, grupi i auditimit i ka trajtuar në një pretendim.

nënshkruar nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Edhe pse Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, citon se “komisioni për verifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake ka në përbërje nëpunës, kategoria “përgjegjës sektori”, konstatohet se komisioni nr.48 është firmosur nga 3 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë. Ndërsa, procesverbali i komisionit përkatës, i vendosur në dispozicion grupit të auditimit nuk ka gjurmë të refuzimit të urdhërit të eprorit (nga specialistët pjesëmarrës në komision), në kundërshtim me Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neni 43, pika 3 përcakton se “Nëse nëpunësi civil ka dyshime për paligjshmërinë e urdhrin të eprorit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.”

-Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

- 1.Z.E. K, në cilësinë e drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
- 2.Znj. A. D, në cilësinë e drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
- 3.Znj. E. M, në cilësinë e përgjegjëses pranë sektorit të VNM-së;
- 4.Znj. J. M, në cilësinë e anëtares së komisionit;
- 5.Znj. J. T, në cilësinë e anëtares së komisionit;
- 6.Znj. E. Sh, në cilësinë e anëtares së komisionit;
- 7.Znj. E. Z, në cilësinë e anëtares së komisionit;
- 8.Z. O. Dh, në cilësinë e anëtarit të komisionit;
- 9.Znj. L. Gj, në cilësinë e anëtares së komisionit;
- 10.Znj.O. N, në cilësinë e anëtares së komisionit.

➤ **Subjekti i audituar:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Çështjet e audituara: Audituesit e KLSH-së kanë kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për vënie në dispozicion të mendimit sygjerues (i cili është dërguar AKM-së, para miratimit të VNM-së paraprake) për ndërtimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.

Lidhur me auditimin në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura:

-Pas marrjes së aplikimit për projektin “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale-Përmet”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, i ka dërguar për mendim një kopje të aplikimit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

-Me shkresën (në formë elektronike), në datë 19.10.2021, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura i kthen përgjigje AKM-së, se “Sipërfaqja referuar koordinatave ku do të zhvillohet aktiviteti “Instalimet për asgjësimin e mbetjeve”, me zhvillues “Ministria e Mjedisit”, me AN131020210003 në koordinatën (439150.699, 4458956.721), është 93 metër larg kufirit të Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”. Subjekti të ndërtojë një brez të gjelbërt dhe të mbjellë lule aromatike përreth zonës ku do të zhvillohet aktiviteti”.

Nga auditimi u konstatua se:

1.Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka dhënë mendim sygjerues pozitiv (për ndërtimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë) dhe si pasojë nuk ka marrë në konsideratë për të krijuar/ruajtur një zonë sigurie në afërsi të kufirit natyror të zonës së mbrojtur “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”.

-Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është paraqitur observacioni me shkresë me nr.968/12 prot., datë 21.10.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura: Përsa i përket konstatimit 1 sqarojmë se: “VKM nr. 57, datë 06.02.2019 përcakton kriteret për zonimin e territorit të një zone të mbrojtur. AKZM ka rol të rëndësishëm në monitorimin e aktiviteteve brenda kufijve të zonave të mbrojtura, për të siguruar që ato përputhen me objektivat e ruajtjes. Aktiviteti “Instalim për asgjësimin e mbetjeve” që ndodhet 93 metra larg kufirit të Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli” është jashtë kompetencave të AKZM”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Merret pjesërisht në konsideratë dhe reflektohet në pjesën e projekt raportit. Por, aplikimi "i parimit të parandalimit", përcakton mbrojtjen e burimeve natyrore, që përfshin identifikimin dhe marrjen e masave të përshtatshme për mënjanimin dhe menaxhimin aktiv të kërcënimeve dhe rreziqeve.

Nga akt-verifikimi i mbajtur nga grupi auditues në prani të përfaqësuesve të Bashkisë Përmet (në datë 10.10.2024), në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, i cili ndodhet 93 m larg nga kufiri i zonës së mbrojtur, janë konstatuar problematika⁸.

Për sa më lart, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në dhënien e mendimit për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, nuk ka marrë në konsideratë risqet potenciale të ndërtimit/operimit të një venddepozitimi mbetjesh urbane (aktivitet me ndikim negativ në mjedis), me vendndodhje: në afërsi të kufirit të Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”.

Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

1.Z. Z. D, në cilësinë e titullarit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

➤ **Subjekti i audituar:** Bashkia e Përmetit

Çështjet e audituara: Audituesit e KLSH-së, kanë kërkuar informacion nga Bashkia e Përmetit për vënie në dispozicion të dokumentacionit, konkretisht; dosjen e aplikimit për leje infrastrukturore për ndërtimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, aplikimin për lejen e mjedisit, aplikim për licencën e transportit të mbetjeve urbane, kërkesën pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për mbylljen e venddepozitimeve urbane ilegale.

Lidhur me auditimin në Bashkinë e Përmetit:

-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (në rolin e zhvilluesit) ka vijuar procedurën e aplikimit për leje infrastrukturore për ndërtimin e një objekti (venddepozitimi) në fshatin Piskovë në njësinë administrative Qendër- Piskovë.

-Bashkia Përmet ka miratuar lejen infrastrukturore me nr. 4, datë 17.11.2021.

Për sa më lart konstatohet se:

1.Bashkia Përmet nuk ka marrë në konsideratë mendimin e Agjencisë së Menaxhimit të Baseneve Ujore, e cila citon se “vendndodhja e propozuar ndodhet në zonë me rrezik përmbetjeje. Për këtë sygjerojmë zgjedhjen e një vendndodhjeje të re, që nuk rrezikon ndotjen e trupave ujor në afërsi të tij”, kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 21, pika 2, përcakton se “Brenda 35 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për leje, zyra/organi përgjegjës i planifikimit pranë autoritetit vendor kryen shqyrtimin teknik dhe merr kryesisht, të gjitha opinionet dhe aktet e pëlqimit/ miratimit që mund të jenë të nevojshme, sipas rastit.”

⁸ Akt verifikimi është pasqyruar në faqen 23 dhe 24 të raportit të auditimit.

2.Në dokumentacionin e aplikimit për leje infrastrukturore, mungon dokumenti i pronësisë, (në lejen e infrastrukturës të miratuar nga Bashkia e Përmetit me nr. 4, datë 17.11.2021, përmendet se “në dokumentacionin shoqërues të kërkesës janë dokumentacioni: Kopje e dokumentit të pronësisë...”);

3.Raporti i inspektimit (i mbajtur nga një prej subjekteve fitues të procedurës së prokurimit “DC*” i vendosur në dispozicion grupit të auditimit⁹ përmend se “bashkia Përmet ka propozuar që lëndfilli të ndërtohet në një zonë të re pranë fshatit Piskovë. Sipërfaqja është 7000 m²”. Raporti nuk përmban elementët e dokumentit zyrtar, kjo në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 17, përcakton se “Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës. Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës”.

4.Bashkia Përmet nuk ka aplikuar për leje mjedisi për operimin/funksionimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane, kjo në kundërshtim me VKM Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfilllet e mbetjeve”, Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e Mjedisit “ të ndryshuar si dhe kushtit 3.23 të Vendimit të VNM paraprake, i cili përcakton se “Duke qenë se gjatë fazës së funksionimit, aktiviteti duhet mbajtur në monitorim të vazhdueshëm, projekti duhet t’i nënshtrohet procedurës për Leje Mjedisore.”

5. Procesi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane, për në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, kryhet pa licencën III.2/B, kjo në kundërshtim me Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe me ligjin nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 57, pika 1, përcakton se “Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licensë të vlefshme për transportin e mbetjeve”. Procesin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë e Përmetit e realizon “Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit”.

6.Leja infrastrukturore për ndërtimin e venddepozitimit është miratuar në kundërshtim me “Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e mbetjeve të ngurta”, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, datë 13.01.2020. Plani Kombëtar Sektorial parashikon ndërtimin e një stacioni transferimi mbetjesh urbane, për bashkinë e Përmetit dhe Këlcyrës, i cili ende nuk është miratuar nga institucionet përgjegjëse¹⁰.

7.Bashkia Përmet nuk ka aplikuar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për mbylljen e venddepozitimeve ilegale, në kundërshtim me Vendimin nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfilllet e mbetjeve”, i ndryshuar, kreu X “Procedurat e mbylljes dhe të kujdesit pas mbylljes”, pika 20 përcakton se “Operatori i vendit të lëndfillit fillon procedurat e mbylljes për të gjithë vendin e lëndfillit...”.

8.Relacionet gjeologjik-hidrologjik-topografik (të paraqitur në dosjen e aplikimit për leje infrastrukturore) nuk janë nënshkruar nga individë që janë të pajisur me licensat profesionale përkatëse, kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 943, datë 28.12.2016 „Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", neni 1, përcakton se “Çdo individ apo person juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim

⁹ Raporti i inspektimit është vendosur në dispozicion nga Bashkia e Përmetit.

¹⁰ Kthim përgjigje me email nga Bashkia e Përmetit.

duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse dhe të regjistrohet në regjistrat profesionale të subjekteve të licencuara në këto fusha, bazuar në rregulloren bashkëlidhur këtij vendimi".

-Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Bashkia Përmet është paraqitur observacioni me nr.2644/1 prot., datë 17.10.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Bashkisë Përmet: Në lidhje me pikën 1 të akt konstatimit “*AMBU në përgjigjen e saj lidhur me rrezikun e përmbytjes së zonës së venddepozitimit, nuk ka marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për zonat e përcaktuara si zona me rrezik potencial përmbytje. Referuar Vendimit Nr. 1, datë 15.06.2021*”Për miratimin e Raporteve të Vlerësimit Paraprak të Rreziqeve nga Përmbytjet për Basenet Ujore Drin-Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe shpalljen e zonave ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje”, të Këshillit Kombëtar të Ujit, në Aneksin III “Zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje (zrrpp-të)”, nuk përfshihet si zonë me rrezik përmbytje vendi ku është ndërtuar venddepozitimi i mbetjeve në bashkinë Përmet. AMBU nuk n'a ka vënë në dispozicion asnjë dokument zyrtar apo studim pjesor apo të plotë mbi rrezikun e përmbytjes në atë zonë, i cili do të kundërshtonte Vendimin Nr. 1, datë 15.06.2021 të KKKU”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, ky pretendim nuk merret në konsideratë. Referuar Vendimit Nr.867, datë 10.12.2014 “*Për procedurën e bashkëpunimit në institucionet e administratës publike*”, kreu II, pika 3 përcaktohet se “*Në çdo moment kur një institucioni të administratës shtetërore i nevojiten, me qëllim realizimin e funksioneve të tij, të dhëna apo informacione që disponohen nga një institucion tjetër, ai ka të drejtë t'i drejtohet drejtpërdrejt atij institucioni*”. Për sa më lart, Bashkisë Përmet i janë vendosur informacione nga institucioni kërkues (AMBU) se zona e përzgjedhur për ndërtimin e venddepozitimit është me rrezik përmbytjeje, por këtë mendim Bashkia nuk e ka marrë në konsideratë.

Pretendimi i Bashkisë Përmet: Nga ana e MTM është dërguar shkresa me nr.9322 prot., datë 19.11.2018, ku kërkohet marrja e masave për rehabilitim apo mbyllje të venddepozitimeve. Bashkia Përmet me nr.2985 prot., datë 23.11.2018, ka dërguar masat për rehabilitim të venddepozitimit “Braçkovë”. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me anë të shkresës me objekt “Kthim përgjigje”, me nr.4151/7 prot., datë 14.10.2019, vendos në dijeni Bashkinë Përmet se “Plani i përmirësimit për venddepozitimin e mbetjeve në Braçkovë, Bashkia Përmet”, nuk miratohet.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Referuar Vendimit Nr. 452, datë 11.7.2012 “*Për lëndfillet e mbetjeve*“ i ndryshuar, operatori i venddepozitimit që në këtë rast është Bashkia Përmet bën kërkesë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për mbylljen e venddepozitimit të mbetjeve urbane.

Pretendimi i Bashkisë Përmet: Për pikën 8 të akt konstatimit “*Studimi dhe projektimi i veprës “Mbyllja, Rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale” është kryer nga bashkimi i operatorëve ekonomik “DC” shpk, “A C” shpk dhe “U 0”shpk, sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 3492 Rep., nr.1266 Kol, datë 30.05.2019. Në bazë të prokurës nr.3493 Rep., nr.1267 Kol., datë 30.05.2019, subjekti “DC” shpk, autorizohet të përfaqësojë bashkimin e operatorëve dhe për të kryer të gjitha procedurat juridike në lidhje me objektin “Mbyllja, Rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale”.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, ky pretendim nuk merret në konsideratë. Në prokurë, nuk specifikohet që subjekti "DC" sh.p.k të firmosë relacionet gjeologjik-hidrologjik-topografik.

➤ **Grupi i auditimit ka kryer verifikime dhe vëzhgime në terren në venddepozitimin e mbetjeve në Piskovë dhe ka konstatuar problematika, konkretisht:**

Më datën 10.10.2024, ora 12.00, grupi i auditimit, në prani të përfaqësuesve të Bashkisë Përmet z. F. H, me detyrë Nënkryetar i Bashkisë Përmet dhe z. A. J, me detyrë punonjës i shërbimeve në Bashkinë Përmet, ka mbajtur aktin e verifikimit, për situatën konkrete në venddepozitimin e Piskovës si më poshtë;

1. Venddepozitimi është i rrethuar, me shtylla hekuri i veshur me tel zinkat me (rrjet teli).
2. Kanalet e jashtëm të kullimit, janë të pastruara dhe ka segmente që janë hedhur inerte dhe mund të cojnë në bllokimin e tyre.
3. Mungojnë tabelat që japin informacion për zonën dhe rrezikshmërinë e saj.
4. U konstatua se nuk bëhet ndarja e mbetjeve në burim dhe as në venddepozitim.
5. Mbeturinat janë hedhur në mënyrë jo të rregullt dhe nuk kryhet në mënyrë permanente procesi i presimit, shtresëzimit dhe mbulimit me dhë, sipas rregullave të menaxhimit.
6. Gjatë verifikimit në vend, masat mbrojtëse në krahun nga ana e lumit, nuk janë të plota dhe të mbuluara nga dherat. Kjo masë mbrojtëse është rekomanduar, që në fazën e studimit, gjatë zbatimit dhe funksionimit të venddepozitimit.
7. Një pjesë e mbetjeve ndodhen jashtë gropës së venddepozitimit dhe për rrjedhojë ujërat sipërfaqësor të ndotur nga mbetjet, mund të devijojnë jashtë kanaleve kulluese.
8. Venddepozitimi nuk monitorohet me personel gjatë gjithë kohës, gjë e cila mund të bëhet shkak i dëmtimit të rrethimit dhe ndërhyrjeve të paligjshme, sic është zjarrvënja, hyrja e kafshëve etj.
9. Si rezultat i hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve, krijohet rrezik potencial për bllokimin e kanaleve të ujërave të ndotura që shkojnë në gropat e kullimit.
10. Marrja e dherave në afërsi të venddepozitimit, mund të jetë premisë për gërryerje dhe rrëshqitje të mëvonshme, në rastet e shirave të rrëmbyeshëm.
11. Në venddepozitim, deri në momentin e verifikimit nga grupi i auditimit nuk është aplikuar vendosja e shtresave të gjelbëruara.
12. Nuk konstatohet të ketë një sistem ndricimi në venddepozitim dhe as përreth tij.
13. Gjatë verifikimit, konstatohet se në venddepozitim dhe përreth ka një numër shpendësh të egra autoktone, të cilat mund të bëhen burim sëmundjesh dhe ndikimesh tek komuniteti i shpendëve në Parkun Kombëtar “Bredhi i Hotovës” dhe përreth tij.

-Lidhur me projekt raportin (akt verifikimin), nga Bashkia e Përmetit është paraqitur observacioni me shkresë me nr.5613/4 prot., datë 18.10.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në observacionin e Bashkisë Përmet thuhet “Venddepozitimi i mbetjeve është i rrethuar dhe qëndron gjithë kohës i mbyllur, të drejtën e hyrjes në të e kanë vetëm shoferët e sektorit të pastrimit dhe personat përgjegjës të këtij sektori. Pas depozitimit të mbetjeve në këtë venddepozitim, bashkia Përmet ka vënë në dispozicion kapacitete në burime njerëzore dhe mjete transporti, kryen trajtim të tyre duke bërë mbulimin e herëpasshershëm me shtresa dheu të mbetjeve”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Bashkia Përmet nuk jep sqarime dhe arsye, në lidhje me mungesën e masave mbrojtëse, sipas raporteve studimore; nuk janë kryer të plota punët me gjelbërim të venddepozitimit; mbetjet nuk përpunohen dhe janë të shpërndara brenda dhe jashtë venddepozitimit etj.

Theksojmë se, dherat për mbulimin e mbetjeve, në ato pak raste, janë marrë në afërsi të

venddepozitimit (pjesa e sipërme,VP), gjë e cila mund të stimulojë përmbytje dhe gërryerje në raste reshjesh të rrëmbyeshme.

Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

- 1.Zj. A. H, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet.
- 2.Z. L. B, në cilësinë e përgjegjësit të urbanistikës dhe planifikimit të territorit, Bashkia Përmet.
- 3.Z. F. H, me detyrë Nënkyetar i Bashkisë Përmet.
- 4.Z. A. J, me detyrë punonjës i shërbimeve në Bashkinë Përmet.

2.3 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit publik.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit, grupi i auditimit për qëllimin dhe objektin e auditimit të përputhshmërisë në lidhje me prokurimin e kryer nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, është bazuar në zbatimin e bazës ligjore si më poshtë:

- Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.
- Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- VKM-së nr.918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”.
- VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Udhëzim i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve dhe realizimeve të procedurave të prokurimeve publike dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”.
- Cdo akti ligjor dhe nënligjor apo udhëzimi në fuqi, të cilët përcaktojnë procedurën e prokurimeve publike të financuara nga Buxheti i Shtetit dhe që kanë lidhje me këtë objekt prokurimi.

Për auditimin e këtij drejtimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i parashikimit dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2019.
- Planifikimi buxhetor i prokurimeve.
- Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve.
- Dosja e procedurës së prokurimit, realizimin e procedurës që nga momenti i nxjerrjes së urdhërit, deri në lidhjen e kontratës me OE.
- Procedurat e prokurimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) në faqen e APP.
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.
- **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit**

-Bazuar në kërkesën e dorëzuar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit nga ana e Bashkisë Përmet me nr.673 prot., datë 21.03.2019 me lëndën “Kërkesë për bashkëpunim dhe mbështetje” në lidhje me problematikën e depozitimit të mbetjeve urbane në këtë bashki, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka marrë masa për ngritjen e komisionit për hartimin e detyrave të projektimit për

projektin me objekt "Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale", në mbështetje të Ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, si dhe VKM-së nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe koalidim", i ndryshuar.

-Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, me urdhër nr.38, datë 20.02.2019, me nr.1892 prot., urdhërohet ngritja e Komisionit për Hartimin e Detyrave të Projektimit, i përbërë nga:

- R. B (Kryetar)
- L. K (Anëtar)
- Sh. K (Anëtar)

-Në datë 12.03.2019 është mbajtur procesverbali për hartimin e detyrës së projektimit. Komisioni ka vendosur me shumicë votash hartimin e detyrës së projektimit.

Gjatë shqyrtimit të këtij procesverbali për hartimin e detyrës së projektimit me objekt "Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale", në bazë të Urdhërit të Titullarit të AK nr.38, datë 20.02.2019, vërehet se procesverbali është miratuar me shumicën e dy anëtarëve të komisionit, përkatësisht:

- R. B (Kryetar)
- Sh. K (Anëtar)

-Nga procesverbali për hartimin e detyrës së projektimit me objekt "Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale", në bazë të Urdhërit të Titullarit të AK nr.38, datë 20.02.2019 rezulton se anëtarja e Komisionit znj. L. K nuk ka pranuar të firmosi procesverbalin, pasi nuk është dakordësuar me këtë detyrë. Gjithashtu, në dosjen përkatëse nuk rezulton asnjë argumentim nga ana e saj për arsyet e kundërshtimit si dhe bashkëlidhur procesverbalit mungon njoftimi i eprorit për këtë kundërshtim, si dhe konfirmimi nga ana e këtij të fundit, në kundërshtim me nenin 43 të Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

▪ **Përcaktimi i kriterëve teknike dhe fondit limit**

-Në datë 15.05.2019 është mbajtur një procesverbal në Drejtorinë e Prokurimeve dhe Partneriteteve për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 57 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.

Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, rezulton se ka marrë oferta nga tre operatorë ekonomik me objekt të veprimtarisë të njëjtë/ngjashme me objektin e prokurimit. Operatorët ekonomik janë si më poshtë:

	Oferta
1. "AE E" SH.P.K	345.000.00
2. "F S" SH.P.K	340.000.00
3. "I D" SH.K.P	315.000.00

-Në bazë të përlllogaritjes së mesatares së ofertave të mësipërme, fondi limit është përlllogaritur në vlerën 3.333.333 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

-Në mbështetje të Ligjit nr: 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, është urdhëruar të kryhet procedura e prokurimit "Shërbim Konsulence" nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) z. P. A, me anë të Urdhrit nr. 152, datë 15.05.2019, me mjete elektronike, me objekt "Studimi, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale" me fond limit 3.333.333 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Njësia e Prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit përbëhet, si më poshtë:

- A. L Kryetar
- E. R Anëtar (Eksperte e fushës)
- Sh. H Anëtar

-Tabela nr.1 “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale”

Të dhëna të përgjithshme të procedurës

Urdhër prokurimi nr.152 prot., datë 15.05.2019	NJHDT A. L	KVO me urdhrin nr. 153 prot, datë 15.05.2019
Fondi limit 3.333.333 Lekë	E. R	R. B– Kryetar
Procedura e prokurimit- Shërbim Konsulence	Sh. H	D. Xh – Anëtar Sh. K – Anëtar
Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit		
Ankimime për vlerësim në AK - Jo	Afati kontratës: 45 ditë nga data e nëshkrimit të kontratës.	Titullar i AK – Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) z.P. A

Burimi: Regjistri i Parashikimit për MTM, vënë në dispozicion nga MTM

-Nga verifikimi i dokumentacionit faktik në dosjen e prokurimit, konstatohet se në regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve për vitin 2019, procedura e prokurimit me mjete elektronike nuk është kryer komfort legjislacionit dhe manualeve për kryerjen e procedurës në mënyrë elektronike. Nga auditimi i kryer për procedurën e dokumentimit elektronik, rezulton se AK nuk ka ndjekur hapat për pasqyrimin e dokumentacionit dhe procedurës sipas nenit 4 të VKM nr.914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikës 3 të Udhëzimit nr.1, datë.05.01.2018 të APP “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik...”

▪ **Hartimi i DST-të**

Në datë 16.05.2019 është mbajtur procesverbali për miratimin e DST, në të cilin përcaktohet se: ...pas administrimit të dhe rekomandimeve të APP, Njësia e Prokurimit ka miratuar DTS, dhe ka përcaktuar se...kriteret e përgjithshme mbeten të pa ndryshuara ashtu si dhe çdo pjesë e standarteve në DST të vendosura nga APP. Me procesverbal, datë 22.06.2022, NJHDT, ka miratuar shtojcat që do të jenë pjesë e DST-ve.

-Më urdhër nr.153, datë 15.05.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave nga OE për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulence” me mjete elektronike, me objekt “Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane në venddepozitimet ilegale”, me fond limit 3.333.333 lekë pa TVSH, i përbërë prej:

- R. B Kryetar
- D. Xh Anëtar
- Sh. K Anëtar

-Me shkresën me nr. 4649/2 prot., datë 16.05.2019 nga AK është bërë njoftimi i kontratës, i cili më pas është publikuar elektronikisht në SPE.

-Me urdhërin nr. 165, datë 23.05.2019, me nr. 4649/3 prot., të Titullarit të AK, është urdhëruar pezullimi i procedurës së prokurimit bazuar në problematikat e evidentuara nga APP gjatë kësaj procedure prokurimi, pasi APP ka vlerësuar se disa prej kriterëve të përcaktuara në DT nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm, pikës 1 të nenit 46, të LPP, si dhe nenit 28 të VKM nr. 914 “Për rregullat e prokurimit publik”. Gjithashtu APP ka dhënë në mënyrë elektronike, me email dhe rekomandimet e ndryshimeve të nevojshme që duhet të ndërmerren nga AK.

-Shtojca 10, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit Pika 2.1”: 1 “Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë” 1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 6;

b Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;” modifikohet si më poshtë:

ISHTE	BËHET
1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: a. Sigurimin e Ofertës (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 6; b Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8; c. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9; ç. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.	a. Sigurimin e Ofertës (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 6; b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 4/1 c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8; ç. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9; d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

-Shtojca 10, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit” tek pika Pika 2.2 “Kapaciteti teknik” “2.Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një listë të Drejtuesve Teknik të punësuar për periudhën prill 2018 – prill 2019 në të cilin të ketë” modifikohet si më poshtë:

ISHTE	BËHET
2.Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një listë të Drejtuesve Teknik të punësuar për periudhën Prill 2018 – Prill 2019 në të cilin të ketë personelin e mëposhtëm: -1 (një) Inxhinier Ndërtimi, me eksperiencë profesionale mbi 10 vite, i cili do të jetë drejtuesi kryesor i ekipit të projektimit. -1 (një) Inxhinier Hidroteknik me eksperiencë profesionale mbi 10 vite, -1 (një) Inxhinier Gjeodet me eksperiencë profesionale mbi 10 vite, -1 (një) Inxhinier Gjeolog me eksperiencë profesionale mbi 10 vite, -Per inxhinierët e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: 1. Cv shoqëruar me deklaratën e disponueshmërisë për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë stafi i angazhuar; 2. Diplomat e inxhinierëve; 3. Licensat individuale në projektim; 4. Kontratë të vlefshme pune ose bashkëpunimi.	-1 (një) Inxhinier Ndërtimi, me eksperiencë profesionale mbi 5 vite, i cili do të jetë drejtuesi kryesor i ekipit të projektimit. -1 (një) Inxhinier Hidroteknik me eksperiencë profesionale mbi 5 vite, -1 (një) Inxhinier Gjeodet me eksperiencë profesionale mbi 5 vite, -1 (një) Inxhinier Gjeolog me eksperiencë profesionale mbi 5 vite, 1. Cv shoqëruar me deklaratën e disponueshmërisë për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë stafi i angazhuar; 2. Diplomat e inxhinierëve; 3. Licensat individuale në projektim; 4. Kontratë të vlefshme pune ose bashkëpunimi.

-Shtojca 10, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit” tek pika Pika 2.2 “Kapaciteti teknik” “Gjithashtu subjekti duhet të jetë i Licensuar nga QKL.” modifikohet si më poshtë:

ISHTE	BËHET
-Gjithashtu subjekti duhet të jetë i Licensuar nga QKL për ekspertizë në lidhje me ndikimin në mjedis.	-Gjithashtu subjekti duhet të jetë i Licensuar nga QKL për ekspertizë në lidhje me ndikimin në mjedis me certifikatën me kod: III.2.A (1+2) për kategorinë “Shërbim ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.

-Shtojca 10, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit” tek pika Pika 2.2 “Kapaciteti teknik” pika 4 ” 4.Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 20 (njëzet) punonjës për periudhën prill 2018 – prill 2019, vërtetuar Përvojë të mëparshme.....” modifikohet si më poshtë:

ISHTE	BËHET
4.Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 20 (njëzet) punonjës për periudhën prill 2018 – prill 2019, vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e mësipërme shoqëruar me formularët e listëpagesave E-SIG-25.	4.Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 20 (njëzet) punonjës për periudhën janar 2019 – prill 2019, vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e mësipërme shoqëruar me formularët e listëpagesave E-SIG-25.

-Shtojca 10, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit” tek pika Pika 2.2 “Kapaciteti teknik” pika 5 ” 5.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme)” modifikohet si më poshtë:

ISHTE	BËHET
5.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).	5.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim.

Shtojca 10, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit” tek pika Pika 2.2 “Kapaciteti teknik” pika 6 “6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” (e vlefshme)” modifikohet si më poshtë:

ISHTE	BËHET
6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).	6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim.

-Nga auditimi i kryer është konstatuar se kriteret e vecanta të vendosura nga AK nuk janë të argumentuara dhe nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm, pikës 1, të nenit 46, të LPP, si dhe nenit 28 të VKM nr. 914 , datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”. NJP në këtë rast ka kryer ndryshimet e kërkuara sipas direktivave të APP, por ato nuk janë të dokumentuara dhe të argumentuara sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 2 e VKM nr.914, datë 29.12.2014.

-Me urdhër nr.168, datë 20.05.2019, me nr. 4649/4 prot., është bërë heqja e pezullimit të procedurës së prokurimit. Në bazë të ndryshimeve të përcaktuara sa më sipër, në zbatim të nenit 42, pika 2/1, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 62 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, janë bërë ndryshime në afatin kohor për dorëzimin e ofertës nga operatorët ekonomik.

Ishte: Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje.

Data: 27.05.2019, ora 11:00

Bëhet: Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ose kërkesa për pjesëmarrje:

Data: 03.06.2019, ora 11:00

▪ **Vlerësimi i ofertave nga KVO**

-Me procesverbalin nr.1, datë 03.06.2019 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me prezencën e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, ka bërë hapjen e ofertave me mjete elektronike, ku në listën e shfaqur rezultojn këta operatorë ekonomik si më poshtë:

Nr.	Emri i ofertuesit ekonomik	NIPT
1	“I D-A” SH.P.K.	K.....
2	BO “D C” SH.P.K dhe “A C” SH.P.K dhe “U-0” SH.P.K, përfaqësuar me prokurë nga “DC” SH.P.K	K.....

-Me procesverbal nr.2, datë 06.06.2019, KVO ka nisur procedurën e vlerësimit të ofertave. Pas shqyrtimit të dokumentacionit KVO ka vendosur të kualifikojë operatorin ekonomik “I D-A”sh.p.k dhe operatorin ekonomik BO “DC” SH.P.K dhe “A C”sh.p.k dhe “U-0”sh.p.k, përfaqësuar me prokurë nga “DC”sh.p.k.

- Me shkresën me prot. nr.4649/5, datë 14.06.2019 , nga NJP është bërë ftesa për propozim OP “I D-A” sh.p.k.

-Me shkresën me nr.4649/6 prot., datë 14.06.2019 është bërë ftesa për propozim për OP, BO “DC” sh.p.k dhe “A C” sh.p.k dhe “U-0” sh.p.k përfaqësuar me prokurë nga “DC” sh.p.k.

-Me procesverbalin nr.3, datë 01.07.2019, nga ana e AK dhe KVO është kryer hapja e propozimeve teknike:

- Zarfi i dorëzuar nga “I D-A” sh.p.k.
- Zarfi i dorëzuar nga BO “B-V E” sh.p.k dhe “I C E” sh.p.k dhe BO “G C” sh.p.k dhe “I” sh.p.k, përfaqësuar me prokurë nga “DC” sh.p.k.

-Gjatë auditimit të procesverbalit për hapjen e propozimeve teknike konstatohet se bashkimi i operatorëve të përfaqësuar nga “DC” sh.p.k nuk rezultojn në asnjë moment pjesëmarrës në procedurën e prokurimit në fjalë dhe gjithashtu nuk është verifikuar në asnjë procesverbal,

dokumenti “Prokurë e Posacme” nga OE që përfaqëson këtë BOE, në kundërshtim më nenin 44, të Ligjit 9643 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 74, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”.

-Me procesverbal nr. 4, datë 03.07.2019 është kryer vlerësimi i propozimeve teknike nga ana e KVO për operatorët ofertues si më poshtë:

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlerësimi Total (pikë) (Për propozimin teknik)
1	“I D-A” sh.p.k	70 pikë
2	BO “D” SH.P.K dhe “A C” SH.P.K dhe “U-0”SH.P.K, përfaqësuar me prokurë nga “DC”SH.P.K	96 pikë

-Me shkresë nr. 6272 prot., datë 04.07.2019 dhe shkresë nr. 6273 prot., datë 04.07.2019 është bërë njoftimi për procedurë i OP, për njoftimin e datës së hapjes së ofertës ekonomike.

-Me shkresë nr. 6512 prot. datë 12.07.2019, nga AK është bërë njoftimi i operatorit ekonomik BO “DC” sh.p.k dhe “A C” sh.p.k dhe “U-0”sh.p.k, përfaqësuar me prokurë nga “DC” sh.p.k për hapjen e propozimit ekonomik.

-Me procesverbal nr.5, datë 15.07.2019 është kryer procedura e hapjes së propozimeve ekonomike të paraqitura nga dy operatorët ekonomik.

-Me procesverbal nr.6, datë 15.07.2019 është kryer procedura e vlerësimit të propozimeve ekonomike të paraqitura nga OE me propozimet si më poshtë:

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Oferta Ekonomike (lekë pa TVSH)
1.	“I D-A” SH.P.K.	3.299.965.60 lekë
2.	BO “DC” SH.P.K dhe “A C”SH.P.K dhe “U-0”SH.P.K, përfaqësuar me prokurë nga “DC”SH.P.K	3.295.000.00 lekë

-KVO, sipas procedurës ka vlerësuar operatorët me vlerësimin total si më poshtë:

1. Oferta e BOE “DC” sh.p.k dhe “A C” sh.p.k dhe “U0” sh.p.k, përfaqësuar me prokurë nga “DC” sh.p.k me **96.8 pikë**.
2. Oferta e “I D-A” sh.p.k. me **75.96 pikë**.

-Me shkresë me nr. 6686 prot. datë 17.07.2019 është kryer njoftimi përfundimtar i vlerësimit të ofertave si më poshtë:

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Renditja
1.	“I D-A” SH.P.K.	Në vend të dytë
2.	BO “DC” SH.P.K dhe “A C”SH.P.K dhe “U-0”SH.P.K, përfaqësuar me prokurë nga “DC”SH.P.K	Në vend të parë

-Në përfundim të procedurës së vlerësimit të ofertave, nga ana e KVO është përpiluar raporti përmbledhës më datë 24.07.2019 me nr. 4649/7 prot.

▪ Njoftimi i fituesit

-Me shkresë nr. 6995 prot., datë 29.07.2019 është dërguar pranë APP, formulari i njoftimit të fituesit, në formë të shkruar dhe elektronike (CD).

-Në datë 06.08.2019, me nr. 6999/1 prot., nga ana e AK dhe OE është firmosur kontrata e prokurimit “Shërbim Konsulence”, me mjete elektronike REF-22351-05-16-2019 me objekt “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale”.

-Gjatë shqyrtimit të SPE, konstatohet se në sistemin elektronik, kjo procedurë rezulton e papërfunduar. Nga ana e NJP nuk janë plotësuar elementët e procedurës së prokurimit publik në sistemin elektronik sic përcaktohet në Udhëzimin nr 4, datë 09.05.2017 të APP.

▪ **Marrja në dorëzim**

-Me urdhër nr. 284, me nr. 4649/8 prot., datë 06.08.2019 nga ana e AK është urdhëruar ngritja e grupit të punës për marrjen në dorëzim të shërbimit referuar procedurës së prokurimit “Shërbim Konsulence”, me mjete elektronike, me objekt “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale”, i përbërë si më poshtë:

- V. G Kryetar
- Sh. K Anëtar
- Sh. H Anëtar

-Me shkresën nr.4649/9 prot., datë 07.08.2019 është dërguar pranë APP, njoftimi i kontratës së nënshkruar i përmbledhur, në formë të shkruar dhe elektronike (CD).

-Me shkresën nr.4649/10 prot., datë 02.09.2019 nga AK është dërguar kërkesa drejtuar APP për arkivim të procedurës së prokurimit “Shërbim Konsulence”, pas përfundimit me sukses të kësaj procedure.

-Me shkresë nr.7962 prot., datë 13.09.2019 nga ana e OE fitues “DC” sh.p.k është dorëzuar tek komisioni i marrjes në dorëzim, dokumentacioni për venddepozitimin e bashkisë Përmet, në formë shkresore dhe elektronike.

Komisioni për marrjen në dorëzim ka mbajtur një procesverbal në të cilin është pasqyruar dokumentacioni si më poshtë:

Projekt-Zbatimi

<i>Projekti teknik (A3)</i>	<i>37 fleta (3 kopje)</i>
<i>Projekti teknik (900x295mm)</i>	<i>10 fleta (3kopje)</i>
<i>Totali</i>	<i>47 fleta (3kopje)</i>

Relacionet teknike

<i>Relacion teknik</i>	<i>14 fleta (3kopje)</i>
<i>Relacion topografik</i>	<i>6 fleta</i>
<i>Relacion gjeologjik</i>	<i>18 fleta</i>
<i>Relacion hidrologjik</i>	<i>21 fleta</i>
<i>Raporti i VNM</i>	<i>66 fleta</i>
<i>Specifikime teknike</i>	<i>15 fleta</i>
<i>Preventivi i punimeve</i>	<i>3 fleta</i>
<i>Grafiku kohor</i>	<i>2 fleta</i>
<i>Totali</i>	<i>145 fleta</i>

1 CD me materialet përkatëse.

• **Konkluzion:**

-Sa i përket auditimit të procedurës së prokurimit, subjekti i audituar, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi, duke u evidentuar mangësi në përmbushjen e kriterëve të vendosura në procedurat e prokurimit dhe përcaktimeve ligjore të procedurës së prokurimit elektronikisht; në përpilimin e saktë të procesverbaleve të mbajtura nga grupet e punës; si dhe mangësive argumentuese.

-Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është paraqitur observacioni me shkresë me nr.968/14 prot., datë 21.10.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:Lidhur me këtë urdhër argumentohet se institucioni (MTM) kryen një parashikim në fund të cdo viti për përcaktimin e investimeve që do të kryej në kuadër të mbrojtjes së mjedisit gjatë vitit pasardhës, parashikim që pasqyrohet në Planin Buxhetor Afatmesëm(PBA) dhe në regjistrin e prokurimeve.

Qëndrimi i grupit auditues:Nga grupi auditues është pranuar argumenti i subjektit dhe gjetja në fjalë është administruar si jo ekzistent.

Pretendimi i subjektit:Nga ana e subjektit argumentohet nuk ka asnjë shkelje ligjore dhe asnjë detyrim për të dhënë shpjegime të mëtejshme për mos arsyetimin e vendimit për mosdakordësi.

Qëndrimi i grupit auditues:Ky observacion nuk është marrë në konsideratë, pasi mosargumentimi i vendimit për të mos firmosur në procesverbalin e pranimit të detyrës në fjalë, është në kundërshtim me ligjin e nëpunësit civil, si dhe rregullores së brendshme të MTM, pasi nuk është dhënë asnjë arsye e vlefshme për mospranimin e detyrës së caktuar nga eprori.

Pretendimi i subjektit:Njësia e Prokurimit ka kryer procedurat e prokurimit elektronik në zbatim të dispozitave ligjore dhe VKM përkatëse për prokurimin publik me mjete elektronike.

Qëndrimi i grupit auditues:Për sa më sipër,observacioni nuk është marrë në konsideratë, pasi grupi auditues ka konstatuar parregullsi nga ana procedurale sipas përcaktimeve të VKM nr.914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe pikës 3 të Udhëzimit nr.1 datë 05.01.2018 të APP.

Pretendimi i subjektit:Nga ana e komisionit pretendohet së procesverbali është plotësuar korrektësisht dhe se gjithë dokumentacioni përkatës ndodhej në zarf në momentin e hapjes së propozimeve teknike.

Qëndrimi i grupit auditues:Ky observacion nuk është marrë në konsideratë nga grupi auditues, pasi në procesverbalin nr.3, operatorët ekonomik janë të ndryshëm nga OE që janë pjesë e procesit të prokurimit dhe bashkimi i OE të përfaqësuar nga “DC*”që kanë dorëzuar propozimet teknike, nuk janë pjesë e këtij procesi, dhe nuk rezulton dokumenti “Prokurë e Posacme”.

Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

- 1.Z. A. K, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- 2.Z. P. A, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit;
- 3.Z. R. B, në cilësinë e Drejtorit të Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit;
- 4.Znj. L. K, në cilësinë e anëtares së Sekretariatit Teknik të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;
- 5.Znj. Sh. H, në cilësinë e anëtares së grupit të punës (për marrjen në dorëzim të shërbimit referuar procedurës së prokurimit shërbim konsulence);
- 6.Znj. V. G, në cilësinë e kryetares së grupit të punës (për marrjen në dorëzim të shërbimit referuar procedurës së prokurimit shërbim konsulence);
- 7.Z. Sh. K, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës (për marrjen në dorëzim të shërbimit referuar procedurës së prokurimit shërbim konsulence);
- 8.Znj. D. Xh, në cilësinë e anëtarit të grupit për vlerësimin e ofertave;
- 9.Z. A. L, në cilësinë e anëtarit të NJP për hartimin e dokumentave të tenderit;
- 10.Znj. E. R, në cilësinë e anëtares të NJP për hartimin e dokumentave të tenderit.

2.4 Mbi auditimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve, monitorimeve për venddepozitimin ekzistues të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë.

- **Mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.**

Nga auditimi konstatohet se Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kryer inspektime në venddepozitimin e mbetjeve urbane në Piskovë, në kundërshtim me Ligjin Nr.10440, datë

07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”i ndryshuar, neni 25/1, pika 3, i cili përcakton se:

“Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake apo deklaratën mjedisore”.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit është paraqitur observacioni me shkresë me nr.9527/6 prot., datë 18.10.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Agjencisë Kombëtare e Mjedisit: Në lidhje me konstatimin e mësipërm në lëndfillin e mbetjeve urbane në Piskovë, Drejtoria e Inspektim-Kontrollit nuk ka kryer inspektime, pasi nuk ka pasur informacion ose indice, nuk kemi asnjë njoftim apo delegim ankese, për sa pretendohet në konstatim. Nga planifikimet mujore, subjekti nuk është parashikuar për inspektim sepse nuk është objekt i një leje mjedisi.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ushtron veprimtarinë në fushën e përgjegjësisë shtetërore, vetëm për rastet e inspektimit të përputhshmërisë të aktivitetit të operatorëve me kushtet/kriteret e përcaktuara në Lejet Mjedisore.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur, ky pretendim nuk qëndron. Drejtoria e Inspektim-Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit nuk e ka inspektuar asnjëherë projektin “Instalim për asgjësimin e mbetjeve” me vendndodhje në Piskovë. Ky projekt është pajisur me VNM paraprake dhe duhej të kryhej inspektimi për zbatimin e kushteve të VNM-së.

Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

1. Z. D. S, në cilësinë e drejtorit të Inspektim-Kontrollit.

- **Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Përmet.**

Nga auditimi konstatohet se bashkia Përmet nuk ka kryer një monitorim (të venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë), i cili të përmbledhet në një raport ku të vendosen të dhëna si: monitorimi i gjendjes në tërësi të venddepozitimit, monitorimi i gjendjes së murit mbajtës, monitorimi i sistemit të kullimit etj, kjo në kundërshtim me Vendim Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfilllet e mbetjeve” i ndryshuar, Metodologjia e vlerësimit dhe e klasifikimit, ku përcakton se “Me qëllim që të vlerësohet nëse një venddepozitim paraqet një risk apo jo ose nëse ka një ndikim të caktuar, nevojitet të kryhet një monitorim rutinë për të gjitha elementet e pranishme në venddepozitimin e mbetjeve. Kjo ka si qëllim vëzhgimin sistematik të ndikimit të mundshëm të një venddepozitimi mbetjesh dhe të organizojë masat që lidhen me ndikimin që keni vlerësuar. Monitorimi ul riskun e neglizhimit të rreziqeve potenciale në venddepozitimin e mbetjeve, si për shembull:

- Kolapsi i brendshëm i venddepozitimit të mbetjeve;
- Kolapsi i venddepozitimit të mbetjeve, shpërthimi i digës;
- Përmytja e venddepozitimit të mbetjeve ose krijimi i “pellgjeve” në sipërfaqe;
- Djegia e venddepozitimit të mbetjeve;
- Mbyllja e venddepozitimit të mbetjeve për shkak se nuk ka më hapësirë të disponueshme.
- Lista e kontrollit për monitorimin duhet të përmbajë veprimet e mëposhtme:
- Monitorimi i gjendjes në tërësi të venddepozitimit;
- Monitorimi i gjendjes së digës kryesore;
- Monitorimi i gjendjes së murit mbajtës;
- Monitorimi i rrjedhës brenda dhe jashtë tubave të venddepozitimit të mbetjeve;

- Monitorimi i gjendjes së gardhit;
- Monitorimi i sistemit të kullimit;
- Monitorimi i sistemit të çlirimit të gazit;
- Monitorimi i përputhshmërisë me modelin e shtresëzimit që është vendosur për venddepozitimin e mbetjeve;
- Monitorimi i pjerrësisë së sipërfaqes së mbetjeve që duhet respektuar (5–10%), me qëllim që të mundësohet largimi i rrjedhës së ujit sipërfaqësor.
- Monitorimi duhet të përmblihet në një raport të thjeshtë, ku vendoset data, si dhe shënimet e nevojshme në lidhje me pikat e përmendura më sipër.”

Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

1. Zj. A. H, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet.

- **Mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.**

Nga përgjigjja e Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura me nr.3020/4 prot., datë 30.09.2024, citohet se “ nuk ka asnjë procesverbal që lidhet me objekt qëllimin e auditimit tuaj, nga viti 2021 e në vijim”, kjo në kundërshtim me Ligjin Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 38, pika 1, përcakton se “Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura, në varësi të ministrit, dhe ka për detyrë administrimin e kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë” dhe me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, neni 29 përcakton se “ Fusha e veprimtarisë së Agjencisë- përgjigjet për hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e objektivave të punës të 2(dy) drejtorive në varësi të drejtëpërdrejtë të saj dhe ADZM në qarqe nën juridiksionin administrativ. Harton planin vjetor, mujor dhe i miraton ato nga drejtori i përgjithshëm i AKZM. Grumbullon dhe administron të dhënat e monitorimit që merren nga ADZM dhe nga institucionet e specializuara”, si dhe të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që përcakton kjo Rregullore.

-Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është paraqitur observacioni me shkresë me nr. 3431/3 prot., datë 18.10.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura: Sa i takon konstatimit për mungesën e inspektimeve në këtë zonë, ritheksojmë edhe një herë faktin që AKZM/AdZM ka kompetenca monitorimi/inspektimi vetëm brenda territorit të zonave të mbrojtura. Sipas nenit 39, të ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" dhe VKM nr.102, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura", AdZM kanë për detyrë administrimin, ruajtjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të zonave të mbrojtura që ndodhen brenda territorit të tyre administrativ.

Në përputhje me këto detyrime, AdZM Gjirokastër, në zbatim të nenit 39 dhe nenit 66, të Ligjit 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", si dhe rregullores së brendshme të institucionit, ka përmbushur detyrat e saj funksionale duke kryer në mënyrë të vazhdueshme monitorime dhe inspektime brenda territorit të zonave të mbrojtura që administron, ku bën pjesë edhe Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", të cilat janë raportuar në mënyrë periodike pranë AKZM-së. Rezultatet e këtyre monitorimeve/inspektimeve tregojnë se gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë denoncim apo rast që të ketë cënuar integritetin e zonës së mbrojtur.

Gjithashtu, në zbatim të legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura, AdZM dhe AKZM kryejnë inspektime periodike në terren, në funksion të monitorimit të vazhdueshëm të respektimit të

rregullave dhe detyrimeve të përcaktuara për mbrojtjen e zonave të mbrojtura. Në çdo rast shkeljeje, janë në fuqi masa ndëshkimore të përcaktuara nga ligji.

Zbatimi rigoroz i këtyre detyrave dhe mekanizmave të kontrollit është esencial për të garantuar mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, në përputhje me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e ruajtjes së natyrës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Merret pjesërisht në konsideratë dhe reflektohet në pjesën e projekt raportit. Përsa i përket argumentimit të AKZM-së, se “ka rol të rëndësishëm në monitorimin e aktiviteteve brenda kufijve të zonave të mbrojtura”, kjo bie në kundërshtim me ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, parimi “Ndotësi paguan” i cili përcakton se “Subjektet, që me veprimet apo mosveprimet e tyre ndotin dhe/apo dëmtojnë mjedisin brenda e jashtë zonës së mbrojtur, paguajnë për rehabilitimin e tij”.

-Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.4128/3 prot., datë 24.12.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga znj.D. P, ku janë shprehur objeksionet.

Pretendimi i znj. D. P: “Në bazë të projekt raportit të KLSH është ngritur një grup pune për kryerjen e monitorimit dhe kontrollit në terren, në kufi me Parkun Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli” në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, me qëllim vlerësimin e ndikimit në ekosistemin e zonës së mbrojtur. Në datë 19.12.2024 është verifikuar në terren venddepozitimi i mbetjeve urbane në fshatin Piskovë nga grupi i punës, i cili me anë të procesverbalit dhe raportit kanë pasqyruar situatën e verifikuar, vlerësimin e ndikimit në veprimtarinë në ekosistemin e zonës së mbrojtur. Në procesverbalin e mbajtur nga grupi i punës është lënë detyrë që të ketë monitorim të vazhdueshëm mbi këtë vendgrumbullim mbetjesh urbane në lidhje me ndikimet që mund të ketë në zonën e mbrojtur “Bredhi i Hotovës-Dangëlli” dhe të bëhen raportime periodike pranë AKZM-së”.

Për mangësitë dhe veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti:

- 1.Z. Z. D, në cilësinë e titullarit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- 2.Znj. D. P, në cilësinë e titullarit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

IV. REKOMANDIME

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve vendosi rehabilitimin e venddepozitimit të Brackovës¹¹, me qëllim për të rritur kohën e funksionimit të tij. Ndërkohë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në rolin e zhvilluesit, nisi procedurën e aplikimit për tu pajisur me VNM paraprake dhe me leje infrastrukturore, për ndërtimin e një venddepozitimi të ri në fshatin Piskovë, veprime në kundërshtim me Vendimin e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, nr.10, datë 18.11.2020. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 9 deri 15 të Raportit të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë në shqyrtim rastin e mësipërm duke nxjerrë të gjitha përgjegjësitë, si dhe të marrë masa që në të ardhmen këto praktika t’i kryejë konform dispozitave ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

¹¹ E konfirmuar edhe nga observacionet e sjella nga nëpunësi civil që ka mbajtur protokollin e takimit të Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve.

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se dosja e aplikimit për VNM paraprake dhe për leje infrastrukturore, përsa i përket venddepozitimit të mbetjeve urbane në Piskovë, ka rezultuar me mangësi në dokumentacion, kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 18 deri 24 të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Bashkia e Përmetit të marrin masa që përpara miratimit të VNM–ve paraprake dhe lejeve infrastrukturore të verifikojnë se aplikimi i kryer është në përputhje me të gjitha kriteret sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sipas Planit Kombëtar Sektoral për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 13.01.2020, në Bashkinë e Përmetit dhe në Bashkinë e Këlcyrës është parashikuar ndërtimi i një stacioni transferimi mbetjesh urbane. Nëpërmjet një përgjigje me e-mail (datë 11.09.2024) nga Bashkia Përmet, vendndodhja e stacionit të mbetjeve urbane nuk është miratuar ende nga institucionet kompetente. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 21 deri 22 të Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve dhe Bashkinë e Përmetit, të koordinojnë punën për përcaktimin e vendndodhjes së venddepozitimit rajonal dhe të vijohet me ndërtimin e tij.

Brenda datës 31.12.2025

4.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i kryer në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë rezultoi se:

-U konstatua se nuk bëhet ndarja e mbetjeve në venddepozitim;

-Mbeturinat janë hedhur në mënyrë jo të rregullt dhe nuk kryhet në mënyrë permanente procesi i presimit, shtresëzimit dhe mbulimit me dhë;

-Gjatë verifikimit në vend, masat mbrojtëse në krahun nga ana lumit, nuk janë të plota dhe të mbuluara nga dherat;

-Një pjesë e mbetjeve ndodhen jashtë gropës së venddepozitimit dhe për rrjedhojë ujërat sipërfaqësor të ndotur nga mbetjet, mund të devijojnë jashtë kanaleve kulluese;

-Venddepozitimi nuk monitorohet me personel gjatë gjithë kohës, gjë e cila mund të bëhet shkak i dëmtimit të rrethimit dhe ndërhyrjeve të paligjshme, siç është zjarrvënia, hyrja e kafshëve, në kundërshtim me ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 43, pikat 6 e 7, neni 44, pika 3, neni 45 e 64 si dhe Vendimit nr. 452, datë 11.7.2012 “Për Lendfillet e Mbetjeve”, Aneksi I. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 23 deri 24 të Raportit të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa për vendosjen në kushte teknike të përpikta për operimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë si: mbulimin e mbetjeve me dhë, mbledhjen e ujërave sipërfaqësor, vendosjen e sistemit të evakuimit të gazit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se “Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit” në Bashkinë e Përmetit, e cila kryen grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane në bashkinë e Përmetit nuk është e pajisur me licencën III.2.B, në kundërshtim me Vendimin nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". Gjithashtu, Bashkia Përmet nuk ka aplikuar për leje mjedisi për venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, në kundërshtim me VKM nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”, Ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e Mjedisit“ të ndryshuar si dhe kushtit 3.23 të Vendimit të VNM paraprake. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr.20 deri 23 të Raportit të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Bashkia e Përmetit të marrë masa për të kryer aplikimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për tu pajisur me:

-Licencën për nënkategorinë III.2.B, për veprimtarinë “grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”;

-Leje mjedisi për venddepozitimin e mbetjeve urbane me vendndodhje në fshatin Piskovë.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në dosjen e prokurimit "Shërbim konsulence", mungon "marrëveshja e noterizuar" ndërmjet operatorëve ekonomik, në kundërshtim me nenin 44, pika 2 të Ligjit nr. 9643 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 74, pika 2 dhe 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 28 deri 29 të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandim: Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për verifikimin e saktë të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomik.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer rezultoi se institucionet me funksion inspektimi si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk kanë kryer inspektime në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë dhe në zonën e mbrojtur Parku Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 38, pika 1 dhe me Ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, neni 25/1, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.32 deri 34 të Raportit të Auditimit).

-Nga auditimi konstatohet se Bashkia Përmet nuk ka kryer një monitorim (të venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë), i cili të përmblihet në një raport ku të vendosen të dhëna si: monitorimi i gjendjes në tërësi të venddepozitimit, monitorimi i gjendjes së murit mbajtës, monitorimi i sistemit të kullimit etj, në kundërshtim me Vendimin nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.33 deri 33 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 7.1: Drejtoria e Kontroll-Inspektimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrë masa për të inspektuar Bashkinë e Përmetit, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve si dhe venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, raport i cili të dërgohet edhe në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Rekomandimi 7.2: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Gjirokastrë të marrë masa për të bërë kontrolle në Parkun Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", konkretisht venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë me qëllim mbrojtjen e burimeve bionatyrore nga dëmtimet, zjarri, të ndotjes së mjedisit, etj.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Rekomandimi 7.3: Bashkia e Përmetit të marrë masa për të kryer monitorimin e gjendjes së venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, murit mbajtës të sistemit të kullimit të tij si dhe problematikave të tjera, për të cilat të përgatitet një raport i detajuar dhe ti dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për njohjen e situatës dhe marrjen e masave për përmirësimin e tyre.

Menjëherë

B.MASA DISIPLINORE

B.I.PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

B.I.I Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; geramat (a, b, c, ç) e nenit 58-"*Llojet e masave disiplinore*", të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje", neni 58, pika a, për:

1.Znj. Sh. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Tërheqjes së Financimit dhe Partneritetit në Turizëm dhe Mjedis, në cilësinë e anëtares të Njësisë së Prokurimit për Hartimin e Dokumenteve të Tenderit, pasi nuk ka ndjekur hapat për pasqyrimin e dokumentacionit dhe procedurës sipas nenit 4 të VKM nr.914 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe pikës 3 të Udhëzimit nr.1 datë 05.01.2018 të APP, pasi kriteret e veçanta të vendosura nuk janë të argumentuara dhe nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm, pikës 1 të nenit 46, të LPP, si dhe nenit 28 të VKM nr. 914 "*Për rregullat e prokurimit publik*". NJP në këtë rast ka kryer ndryshimet e kërkuara sipas direktivave të APP, por ato nuk janë të dokumentuara dhe të argumentuara sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 2 e VKM nr.914.

2.Z. Sh. K. me detyrë specialist në Sektorin e Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Për Marrjen në Dorëzim, pasi dokumentat e mbajtura pas kryerjes së studimeve si: studimi topografik, studimi gjeologjik, studimi hidrologjik, raport i VNM-së dhe dokumenta që kanë të bëjnë me studimin funksional të lendfillit nuk janë të nënshkruara dhe të konfirmuara nga personat përgjegjës të cilët kanë kryer studimin, në kundërshtim me nenin 2/j të VKM 285/2021.

3.Z. D. S., në cilësinë e Drejtorit të Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për moszbatimin e Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 "*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*" i ndryshuar, neni 25/1, pika 3.

- 4.**Z. L. B.**, në cilësinë e përgjegjësit të urbanistikës dhe planifikimit të territorit, Bashkia Përmet, për moszbatimin e Vendimit Nr. 452, datë 11.7.2012 *“Për lendfillet e mbetjeve”* i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 408, datë 13.5.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*.
- 5.**Znj. D. P.**, në cilësinë e titullarit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, për moszbatimin e Ligjit Nr. 81/2017 *“Për zonat e mbrojtura”*, i ndryshuar, neni 38, pika 1.
- 6.**Znj. E. M.**, në cilësinë e përgjegjëses pranë sektorit të VNM-së, Agjencia Kombëtare e Mjedisit për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 *“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”*.
- 7.**Znj. J. M.**, në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 *“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”*.
- 8.**Znj. J. T.**, në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 *“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”*.
- 9.**Znj. E. Z.**, në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 *“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”*.
- 10.**Z. O. Dh.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 *“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”*.

B.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte përkatësisht "vërejtje":

- 1.Z. A. K., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- 2.Z. P. A., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit.
- 3.Znj. L. K., në cilësinë e anëtares së Komisionit për Hartimin e Detyrave të Projektimit.
- 4.Z. R. B., në cilësinë e Drejtorit të Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit.
- 5.Z. A. L., në cilësinë e kryetarit të Njësisë së Prokurimit për Hartimin e Dokumenteve të Tenderit.
- 6.Znj. V. G., në cilësinë e kryetares së Komisionit për marrjen në dorëzim.
- 7.Znj. D. Xh., në cilësinë e anëtares së Komisionit për Vlerësimin e Ofertave.
- 8.Z. Z. D, në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
- 9.Z. E. K., në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
- 10.Znj. L. Gj., në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
- 11.Znj. O. N., në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

C. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Bashkia Përmet pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
- b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT